




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-4822/21 datë:23.02.2021



Npi – 01/47 datë: 04.03.2021

Kuvendi i Komunës së Shtimes, shqyrtoi kërkesën Nr.01-070/05-25092/20 datë: 14.12.2020, të z.Zymer Bajrami nga fshati Rancë, i cili ka kërkuar nga Kuvendi i Komunës së Shtimes, një parcelë tokë (Truall) për ndërtimin e një Shtëpie banimi, meqenëse kam kontakt me donator për ndërtimin e një Shtëpie. Unë jetoj në kushte të vështira me bashkëshorte dhe një fëmijë, me ndihma sociale dhe me shumë sëmundje.

Kuvendi i Komunës, duke u bazuar në nenin 12.2 pika (d) të Ligjit mbi Vetqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008); Pasi që diskutoi për kërkesën e palës, në mbledhjen e mbajtur më: 04.03.2021, nxori këtë:

V E N D I M

PËR REFUZIMIN E KËRKESËS TË ZYMER BAJRAMIT – RANCË

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -II- të rregullt për vitin 2021, të mbajtur më 04.03.2021, me shumicën e votave vendosi që kërkesa me numër: Nr.01-070/05-25092/20 datë: 14.12.2020, e z.Zymer Bajramit nga fshati Rancë të REFUZOHET.

II

A r s y e t i m: Dhënja e pronës së paluajtshme Komunale në shfrytëzim, trajtohet sipas nenit 7 pika 1 të Ligjit Nr.04/L-144 Për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, ku thuhet: "Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës për miratim paraprak pronën e paluajtshme të Komunës për dhënien në shfrytëzim personave fizik dhe juridik, duke paraqitur arsyet dhe interesin publik".

III


Vendimi është aprovuar duke marrë për bazë edhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, si dhe rekomandimin e Drejtorisë për Planifikim Urban Kadastër dhe Gjeodezi.

IV

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

V

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtorisë, Kryetarit të Komunës, Ministrisë të Pushtetit Lokal, dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesja e Kuvendit

Medina Brahaj